

**STATUT DHE AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR  
“WIND ALBANIA” Sh.p.k.**

**KAPITULLI I  
EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

**Neni 1**

**Themelimi**

1. Emri i shoqërisë është “WIND ALBANIA”Sh.p.k.
2. Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
3. Shoqëria fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (këtu e më poshtë e quajtur “QKB”).
4. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe këtë Statut.

**Neni 2**

**Selia**

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga “Robert Shvare”, Kompleksi Sinani, Shkalla 6, Apt.: 2/2. Tirane, Shqipëri.
2. Shoqëria mund të themelojë degë, zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

**Neni 3**

**Objekti**

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të jetë në fushën e:

1. Konsulencë, juridike, ekonomike, inxhinierike në fusha të ndryshme të aktivitetit ekonomik e juridike, si prodhimin e energjive të rinovueshme, transmetimin, importin dhe eksportin e energjisë, studime e projekte në fushën e mjedisit e të tjera të ngjashme.
2. Projektimi dhe realizimi i impianteve të energjisë së rinovueshme.
3. Ndërmjetësimi për realizime të këtyre fushave me fonde publike dhe private, vendase dhe të huaja, sipas nevojave të projekteve.
4. Kryerjen dhe realizimin e të gjitha proceseve ndërtimore që mund të lidhen me to, në të gjitha fazat, nga ideimi i projekteve deri në realizimin e tyre.
5. Si edhe çdo veprimtari e ligjshme e lidhur me aktivitetin kryesor.

**Neni 4**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

**KAPITULLI II  
KAPITALI FILLESTAR THEMELTAR, KONTRIBUTET KUOTAT-PJESËT E  
KAPITALIT**

**Neni 5**

**Kapitali Themeltar dhe Ortakët**

1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është **100 lekë (njëqind lekë)**, e përbërë nga një kuotë, me vlerë **100.00 lekë (një qind lekë)**.  
Ortaku i Vetëm i Shoqërisë është:



- **Z. Afrim Vigani**, lindur më **21.10.1958**, në Tiranë, dhe banues në adresën: Rruga “Robert Shvarc”, Kompleksi Sinani, Shkalla 6, Apt.: 2/2. Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **F81021056T**, i cili zotëron **100 % (një qind përqind)** të kuotave të Shoqërisë; me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

2. Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm shtrihet deri në shumën e kontributit të tij në kapitalin themeltar.

#### Neni 6

##### Kuota dhe Transferimi

1. Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

3. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

### KAPITULLI III

#### ORGANET DREJTUESE TË “WIND ALBANIA” Sh.p.k.

##### Neni 7

##### Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ka këto funksione:
  - Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga Administratori(ët);
  - Emëron dhe shkarkon Administratorin(ët);
  - Emëron dhe shkarkon ekspertin(ët) kontabël dhe/ose likuidatorin(ët) e Shoqërisë;
  - Përcakton shpërblimin e Administratorit(ëve), ekspertit(ëve) kontabël dhe likuidatorit(ëve);
  - Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecuresë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori(ët);
  - Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
  - Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitali të Shoqërisë;
  - Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve, dhe dividendëve;
  - Merr vendim për ristrukturimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
  - Merr vendim për hapjen e degëve dhe/ose zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë;
  - Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuara nga ligji.

##### Neni 8

##### Regjistri i Vendimeve

Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhen të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen. Regjistri i Vendimeve duhet të mbahet nga Shoqëria, dhe çdo regjistrim duhet nënshkruar nga Administratori.

##### Neni 9

##### Administratori(ët)



### ***Administratori dhe mandati përkatës***

1. Shoqëria administrohet nga Administratori i emëruar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
2. Administratori i parë i Shoqërisë është **Z. Afrim Vigani**, lindur më **21.10.1958**, në Tiranë, dhe banues në adresën: Rruga "Robert Shvarc", Kompleksi Sinani, Shkalla 6, Apt.: 2/2. Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **F81021056T**.
3. Mandati i Administratori(ët) është 3 (tre) vjet, i rinovueshëm, dhe mund të zgjatet deri në vendimin pasardhës të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, që vendos për rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e Administratorit(ve) të ri(nj).

### ***Të drejtat e Administratorit(ve)***

1. Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.
2. Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
  - Administron veprimtarinë e Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
  - Përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;
  - Merr masa për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumenteve;
  - Përgatit dhe nënshkruan pasqyrat financiare vjetore dhe bilancet e konsoliduara, përgatit raportin e ecurisë dhe ia dorëzon këto të fundit, bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për miratim;
  - Krijon sistemin(et) e paralajmërimit në lidhje me rrethana, që kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë;
  - Dorëzon në Qendrën Kombëtare të Biznesit dokumentet dhe të dhënat e Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
  - I raporton Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë.
  - Kryen çdo detyrë tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.
3. Administratori mund të autorizojë nëpërmjet një prokure një person të tretë për të përfaqësuar shoqërinë dhe për të nënshkruar çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë;
4. Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacioni në fuqi.

### **Neni 10**

#### **Drejtuesi teknik**

1. Drejtuesi i parë teknik i Shoqërisë është **Z. Afrim Vigani**, lindur më **21.10.1958**, në Tiranë, dhe banues në adresën: Rruga "Robert Shvarc", Kompleksi Sinani, Shkalla 6, Apt.: 2/2. Tiranë, Shqipëri, dhe mbajtës i letërnjoftimit me numër personal **F81021056T**.
2. Drejtuesi teknik ka të drejtat dhe detyrimet e njohura nga legjislacioni në fuqi.

### **Neni 11**

#### **Eksperti(ët) Kontabël të Jashtëm**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë do të auditohen të paktën një herë në vit nga një, apo më shumë, ekspertë kontabël të jashtëm. Me marrjen në dorëzim të raportit përkatës të auditimit, Administratori i Shoqërisë do të marrë të gjitha masat përkatëse për ndreqjen e parregullsive të konstatuara nga raporti.

### **KAPITULLI IV**



## VITI FINANCIAR – SHPËRNDARJE E FITIMEVE

### Neni 12

1. Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik, Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2021.

### Neni 13

#### Shpërndarja e Fitimeve

Pas miratimit të pasqyrave financiare vjetore, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të fitimit, nëse ka.

## KAPITULLI V

### PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

### Neni 14

#### Prishja dhe likuidimi

Në rast se Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos për prishjen e Shoqërisë, do të emërohen një ose më shumë likuidues.

## KAPITULLI VI

### DISPOZITA KALIMTARE

### Neni 15

#### Ligji i Zbatueshëm

Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.


### Neni 16

#### Të Ndryshme

Ky Statut nënshkruhet në 5 (pesë) kopje origjinale, në shqip.

### ORTAKI VETEM

Z. Afrim Vigani



DATE 09.09.2021